

SHPALLJE KËRKESE PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme pronë private, që preken si rezultat i ndërtimit të një kanali që sistemon ujërat që dalin nga një tombino në km 29-870 në segmentin rrugor Rrogozhinë-Elbasan.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Me anë të këtij publikimi në shtyp kërkohet të vëmë në dijeni personat të cilët preken nga ky shpronësim. Vënia në dijeni konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur nga komisioni i posaçëm i shpronësimit pranë Ministrisë së Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrat në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit).

LISTA E PRONARËVE QË DO TË SHPRONËSOHEN SI REZULTAT I NDËRTIMIT TË NJË KANALI QË SISTEMON UJËRAT QË DALIN NGA NJË TOMBINO NË KM 29-870 NË SEGMENTIN RRUGOR RROGOZHINË-ELBASAN

Nr.	Emri	Zona kadastrale	Pasuria	Sipërfaqja tokë arë	Çmimi l/m ²	Vlera në lekë	Kultura jonxhë vlera në lekë	Vlera totale e shpronësimit
1	Xhavit Xhemal Ballhysa	1452	104/15 105/3	1285	700	899500	6040	905540
	Shuma							905540

Vlera totale e këtij shpronësimi është 905 540 (nëntëqind e pesë mijë e pesëqind e dyzet) lekë.